

Komuna e Fushë Kosovës: problemet kryesore dhe trendët buxhetor

Hyrje

1. Komuna e Fushë Kosovës në të gjitha mandatet qeveriswse që nga viti 2000 udhëhiqet nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK). Kryetari aktual i Fushë Kosovës është z. Burim Berisha.
2. LDK mban shumicën e ulëseve edhe në Kuvendin Komunal, në të cilin ka 14 përfaqësues, nga 27 gjithsej sa ka gjithsej KK i Fushë Kosovës. Kjo ia ka mundësuar LDK-së që të qeverisë e vetme me Komunën e Fushë Kosovës, pa pasur nevojë për koalicion me partitë tjera. Në Kuvend të Fushë Kosovës janë të përfaqësuara tetë subjekte të ndryshme politike, ku 14 ulëse i takojnë LDK-së, gjashtë ulëse PDK-së, nga dy ulëse AAK-së dhe AKR, nga një ulëse PSD-së, një ulëse Bashkimi Demokratik i Ashkalinjëve, një ulëse LDD, një ulëse Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK-subjekt që përfaqëson komunitetin egjiptian), si dhe me një ulëse është e përfaqësuar nga partia Partia Demokratike Serbe (SDS).¹
3. Komuna e Fushë Kosovës në vitet e fundit është bërë qendër e rëndësishme e biznesit, në territorin e së cilës janë të vendosura një numër i madh biznesesh. Përveç kësaj, Komuna e Fushë Kosovës është një nga komunat me trendin më të shpejtë të rritjes së numrit të popullsisë dhe ndërtesave të reja kolektive të banimit. Falë këtij aktiviteti të pasur ekonomik, Komuna e Fushë Kosovës ka arrit që të rrisë të hyra vetanake nga taksat për biznese dhe tatimi në pronë.²
4. Komuna e Fushë Kosovës ka një sipërfaqe prej 100 km² dhe popullsi 34.827 mijë banorë.³

¹ Komuna e Fushë Kosovës. Faqja Zyrtare. Kuvendi Komunal. Lista e këshilltareve komunal. 2013. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/fushekosove/Municipality/Assembly/Keshilltaret.aspx>

² Qeveria e Kosovës. Ministria e Financave. Raporti financiar janar – dhjetor 2012. Fq. 13. Komuna e Fushë Kosovës në vitin 2010 ka pasur të hyra në vlerë prej 1.260.000, përderisa në vitin 2012 kjo shumë është rritur për afro 400.000 euro si rezultat i bizneseve dhe rritjes së numrit të ndërtesave.

³ Komuna e Fushë Kosovës. Faqja Zyrtare. Gjeografia dhe demografia e qytetit. 2013. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/fushekosove/City-guide/Geography.aspx>

5. Sipas hulumtimeve të Institutit GAP më 2009, problemet kryesore të banorëve të Komunës së Fushë Kosovës ishin: mungesa e ujit të pijes, gjendja jo e mirë urbanistike, rreziku nga autostrada, ambienti dhe kualiteti jo i mirë i ajrit, mungesa e çerdheve publike.⁴

Problemet kryesore të Komunës së Fushë Kosovës

- 1. Mungesa e ujit të pijes dhe cilësia jo e mirë e tij.** Komuna e Fushë Kosovës problem madhor e ka mungesën e ujit të pijes. Reduktimet gjatë verës në këtë lokalitet shkojnë deri në 15 orë gjatë ditës.⁵ Përveç kësaj, vendbanimet të cilat furnizohen nga ujësjellësit kanë kapacitet të dobët të ujit. Përveç kapacitetit të dobët, në shumë vendbanime të kësaj komune uji i pijes nuk mund të shfrytëzohet për pije shkak i cilësisë jo të mirë të tij.⁶ Kjo dukuri është hasur në fshatin Kuzmin, në qendër të qytetit në banesat kolektive afër NLB Bankës, të banesat e vjetëra afër QKMF si dhe në zonën në dalje të Fushë Kosovës, ana e djathtë në drejtim të magjistrales për Pejë. Në fshatin Sllatinë e Madhe, ku sipas regjistrimit të fundit të popullsisë, jetojnë afro 2 mijë banorë, nuk ka rrjet të ujësjellësit. Banorët e këtij lokaliteti shkojnë në fshatrat e tjera veçmas në fshatin Halilaq dhe Henc për të marr ujin e pijes. Fabrikat e ujit që në Fushë Kosovë që gjenden në fshatin Vragoli dhe në Kozmin nuk arrijnë t'i përmbushin nevojat e qytetarëve të kësaj komune. Autoritetet, shpresat për zgjidhjen e këtij problemi i bazojnë në planet për ndërtimin e fabrikës se re të ujit në fshatin Shkabaj të Prishtinës. Në bazë të hulumtimit të UNDP banorët e Fushë Kosovës thonë se furnizimi i ujit nga ujësjellësi publik është mjaft problematik. Vetëm 5% e familjeve (në krahasim me mesataren e Kosovës 42%) të lidhura me ujësjellësin publik kanë furnizim të pakufizuar me ujë. Rreth 47% e familjeve kanë pasur ndërprerje të furnizimit me ujë për 1 deri në 4 orë në ditë, 38%, prej 5 deri në 10 orë në ditë, kurse 2% kanë përvojë me ndërprerje më të gjata se 11 orë në ditë. Cilësia e ujit të pijshëm nga ujësjellësi publik është gjithashtu më e dobët se mesatarja e Kosovës. Rreth 57% e familjeve të lidhura me ujësjellësin publik kanë pohuar se uji i çezmës është i turbullt nga

⁴ Institutit GAP. "Fushë Kosova – Raport komunal." Nëntor 2009. Fq 7. Burimi: http://www.institutigap.org/documents/13231_Fushe%20Kosova-raporti%20komunal.pdf

⁵ Agjencia e lajmeve "Koha". Fushë Kosova "kallet" nga etja. 05.08.2012. Burimi: <http://www.koha.net/index.php/player.swf%3Fcid%3D1,17,45384.com?page=1,31,110289>

⁶ Radio Evropa e Lirë. Çfarë uji pimë. 16.08.2013. Burimi: <http://www.evropaelire.org/content/article/25077667.html>

papastërtia, 52% kanë thënë se shtypja e tij është shumë e ulët për shfrytëzim shtëpiak, 57% kanë thënë se uji ka shije të keqe, kurse 51% kanë thënë se ka erë të keqe.⁷

2. Problemet nga lumenjtë Sitnica, Prishtevka dhe Drenica.

Kontaminimi i rrjedhjes së lumenjve nga derdhja e kanalizimeve dhe hedhja e mbeturinave paraqet problem tjetër për qytetarët e kësaj komune. Territorin e Fushë Kosovës e përshkojnë lumenjtë Sitnica, Drenica dhe Prishtevka. Kundërmimi i erërave dhe përhapja e insekteve nga këta lumenj vështirëson jetën e përditshme të qytetarëve.⁸ Lumi Prishtevka ngjason në një deponi gjigante mbeturinash. Moszgjidhjen e këtij problemi Komuna e arsyeton me mungesë të buxhetit. Për lumin Prishtevka nuk ka pasur plane për rregullimin e tij. Në pjesën më të madhe të kohës, shtrati i lumit kundërmon. Rrjedha e lumit i bie ujërat fekale dhe atmosferikë nga territori i Komunës së Prishtinës.

3. Ndotja e ajrit.

Komuna e Fushë Kosovës ka një shkallë të lartë të ndotjes së ajrit e cila kryesisht shkaktohet nga veprimtaria e termocentraleve në Obiliq.⁹ Pjesa e zonave urbane të Fushë Kosovës tregojnë se e kanë të pamundur rrobat e lara t'i thajnë në ambientet e jashtme, shkaku i prezencës së madhe të pluhurit. Zonat më të prekura nga kjo gjendje janë zona e quajtur "Unufri", lagjet "Aziz Zhilivoda", "Isë Boletini", "Stefan Gjeqovi", "Marigona", zona e quajtur "Molla e Kuqe" dhe "Butrinti". Në hulumtimin e realizuar nga Qendra Regjionale për Mjedis (REC), 81% e banoreve të Fushe Kosovës problem kryesor ambiental në komunën e tyre e kanë konsideruar mos cilësinë e ajrit.¹⁰

4. Objektet banesore pa mirëmbajtje dhe pa infrastrukturë.

Ndërtesat publike të cilat e përshkojnë hapësirën përreth qendrës së vjetër të qytetit nuk janë gëlqerosur. Në këto ndërtesa vërehet mungesa e dyerve të hyrjes, mungesa e dritareve nëpër shkallët e ndërtesës, mungesa e anësoreve në shkallë, mungesa e ndriçimit në korridoret e brendshme të ndërtesave, mungesa e ashensorëve, si dhe mungesa e aparateve për fikjen e zjarrit. Përveç kësaj, në disa ndërtesa publike hasen të shpërfaqura kablllo të instalimit të brendshëm elektrik të cilat mund të paraqesin rrezik potencial për jetën e banorëve në ato ndërtesa, veçmas për fëmijët. Këto

⁷ Programi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim (USAID). Raporti i anketimit mbi kënaqshme rinë e qytetarëve me shërbimet komunale. Fq 35-36. Dhjetor, 2012. Burimi: http://www.demi-ks.org/repository/docs/Citizen_Satisfaction_Report-Shqip.pdf

⁸ Agjencia e Lajmeve "Koha". Kontaminohet Uji, ngordhin peshqit. 25.06.2012. Burimi: <http://www.koha.net/index.php/player.swf%3Fcid%3D1.15.42501?page=1,13,104704>

⁹ Agjencia "Infoarkiv". Lajm i huazuar nga Dojqe Wella. 2011. Autor, Lindita Azizi. Burimi: <http://lajme.shqiperia.com/lajme/artikull/iden/1047087596/titulli/Ajer-i-rende-mbi-Fushe--Kosove>

¹⁰ Qendra Regjionale për Mjedis. Raporti i të gjeturave nga hulumtimi mbi Planin lokal të veprimit në Mjedis. Prishtinë, janar 2012. Fq 8.

ndërtesa gjenden përgjatë lagjes “Gjon Sereqi”, “Dardania” si dhe në afërsi të stadiumit të qytetit.

- 5. Problemet në lagjet e komuniteteve.** Lagjet që në Fushë Kosovë njihen si lagja “02”, “07”, “028” dhe “029” ku jetojnë afro 5 mijë banorë që i takojnë komuniteteve pakicë në Kosovë, veçmas romë, përballen me probleme të ndryshme. Përfaqësuesit e kësaj zone thonë se problemet kryesore janë mungesa e çerdhes, mungesa e qendrës rinore, mungesa e ujit të pijes, mungesa e ndriçimit publik, mungesa e gjelbërimit dhe e hapësirave sportive dhe rekreative.¹¹
- 6. Mungesa e çerdheve publike.** Komuna e Fushë Kosovës ka vetëm një çerdhe publike. Sipas bashkëbiseduesëve, pjesa më e madhe e prindërve, fëmijët e tyre për shërbimin e çerdheve i orientojnë në institucionet para shkollore të Prishtinës.¹² Nevojën për çerdhe të reja e ka vlerësuar edhe vetë Komuna e Fushë Kosovës e cila konsideron se së paku edhe tri çerdhe të tjera publike i duhen kësaj komune.¹³ Kërkesë në komunë për ndërtimin e çerdhes kanë dorëzuar edhe banorët e fshatit Sllatinë e Madhe.
- 7. Kanalizimet.** Kanalizimi ekzistues në qytetin e Fushë Kosovës është i vendosur para viteve ‘90 dhe aktualisht gjatë të reshurave kanalizimi nuk funksionon duke vërshuar kështu qendrën e qytetit. Disa fshatrave të komunës së Fushë Kosovës u mungon kanalizimi i rregulluar duke orientuar kështu derdhjen e tyre në të ashtuquajtura gropa septike. Kjo gjendje haset në fshatin Bardh i Vogël, Sllatinë e Vogël, fshatin Henc, Batush dhe pjesërisht në fshatin Miradi dhe fshatin Sllatinë e Madhe. Në bazë të hulumtimit të UNDP-së, 43% e banorëve të Fushë Kosovës janë të lidhur me sistemin e kanalizimit, përderisa pjesa tjetër kanë sistem alternativ të derdhjes së ujërave të zeza.¹⁴
- 8. Mungesa e shkollës në fshatin Sllatinë e Vogël.** Në këtë fshatin mungon shkolla fillore dhe nxënësit e këtij lokaliteti udhëtojnë deri në tri kilometër në këmbë për të shkuar në shkollën fillore “Bajram Curri” në fshatin Sllatinë e Madhe. Rruga që përshkoi ata, kryesisht është pa trotuar dhe pa sinjalizim horizontal dhe vertikal.

¹¹ Agjencia e lajmeve “Indeksonline”. Titulli i artikullit. 01 Gusht 2013. Burimi:

<http://www.indeksonline.net/?FaqeID=2&LajmID=66395>

¹² Ky problem është evidentuar edhe në hulumtimet e GAP të vitit 2009. Shih raportin e GAP:

“Fushë Kosova – raport komunal.” Nëntor 2009. Burimi:

http://www.institutigap.org/documents/13231_Fushe%20Kosova-raporti%20komunal.pdf

¹³ Komuna e Fushë Kosovës. Faqja Zyrtare. Rubrika edukimi. Burimi: <http://kk.rks-gov.net/fushekosove/Temat/Education.aspx>

¹⁴ Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim –UNDP. “Mozaiku i Kosovës”. 2012. Fq 37. Burimi: http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/Mozaik/Kosovo_Mosaic_2012_Alb_216_825.pdf

Gjërat pozitive të cilat duhet mirëmbajtur dhe ruajtur


- 1. Hapësira e pishave në Sllatinë.** Bashkëbiseduesit përgjithësisht kanë sugjeruar që njëra nga hapësirat që duhet ruajtur dhe mirëmbajtur është zona e mbjellur me pisha në Sllatinë. Ekzistojnë rreth 40 hektarë të mbjella me pisha të cilat në disa raste u janë ekspozuar prerjes ilegale. Bashkëbiseduesit kanë kërkuar nga autoritetet e Fushë Kosovës që kjo zonë të shpallet me interes të veçantë dhe të bëhen investime duke filluar nga rregullimi i rrugës, instalimi i ndriçimit publik si dhe rregullimi i ulëseve për qytetarët dhe vendosja e kontejnerëve për mbeturina.
- 2. Kalaja e Harilaqit.** Kalaja e Harilaqit është ndërtim i periudhës romake. Muret e kalasë janë zbuluar në vitin 2005 nga arkeologët e Institutit Arkeologjik të Kosovës. Kjo kala mbulon një sipërfaqe prej 1 hektar e 30 ari dhe vlerësohet si një e gjetur me rëndësi të madhe historike dhe turistike për Komunën e Fushë Kosovës. Nga autoritetet lokale kërkohet që gjate periudhës vijuese të investojnë në gërmime të mëtutjeshme afër kësaj kalaje, në konservimin e saj dhe në informimin e opinionit që do të nxiste ata për të vizituar kalanë.

Trendet Buxhetore në Komunën e Fushë Kosovës

Komuna e Fushë Kosovës në vitin 2013 ka planifikuar buxhet prej 6.4 milion eurove, apo rreth 700 mijë euro më shume se në vitin 2010. Të hyrat vetanake të kësaj komune janë rritur vazhdimisht që nga viti 2010 dhe në vitin 2012 kanë qenë 1.6 milion euro. Në anën tjetër, Raporti i Auditorit ka konstatuar se Komuna nuk ka arritur të vendos mekanizmat efektiv për inkasimin e të hyrave vetanake. Pjesën më të madhe të borxhit ndaj komunës e përbën tatimi në pronë me gjithsejtë 1.1 milion euro.¹⁵

¹⁵ZAP, Raporti i Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Komunës së Fushë Kosovës Mbyllur me 31 Dhjetor 2012, 06 Gusht 2013 http://oag-rks.org/repository/docs/RaportiAuditimit_KFK_2012_Shqip_120603.pdf

Figura 1. Buxheti i Komunës së Fushë Kosovës- 2013




Burimi: <http://www.institutigap.org/spendings/?fushe-kosove/2013#/~ /fushe-kosove>

Struktura e shpenzimeve në vitin 2013 dominohet nga “Pagat dhe Mëditjet” (52%) dhe “Shpenzimet Kapitale” (36%). Sa i përket kontrollit të shpenzimeve, Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2012 ka gjetur se në aktivitetet e prokurimit komuna ka bërë shpenzime për mallra dhe shërbime që nuk dihet se në çfarë sasive janë pranuar (derivatet, servisimi i automjeteve, furnizimet me ushqimet etj.).

Në bazë të grafikonit të mëposhtëm rreth ndarjeve buxhetore në tri vitet e kaluara, shohim se krahasuar me vitin paraprak në vitin 2011 shpenzimet kapitale kanë pësuar një rënie të theksueshme prej 447 mijë euro apo 19%.

Figura 2. Trendet e Ndarjeve Buxhetore 2010-2012



Sa i përket planifikimit dhe vlerësimit të të hyrave dhe shpenzimeve, Instituti GAP nuk ka mundur të ketë qasje në Kornizën Afatmesme Buxhetore 2014- 2016 të Fushë Kosovës.



Metodologjia e hartimit të raportit

Instituti GAP në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) janë aktiv në fushën e qeverisjes lokale dhe monitorimin e fushatave para zgjedhore që nga zgjedhjet lokale të 2007. Përgjatë këtyre viteve, në bazë të punës hulumtuese dhe analitike, janë grumbulluar informata për nivelin e qeverisjes lokale, problemet kryesore dhe trendët buxhetore të komunave.

Identifikimi i problemeve kryesore në Komunën e Fushë Kosovës është bërë përmes intervistave dhe fokus grupeve me njerëzit aktiv të komunës, si gazetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile, etj. Të gjeturat e GAP janë mbështetur me të dhënat kuantitative të siguruara përmes anketës së zhvilluar nga ai i UNDP (Mozaiku i Kosovës 2012-shërbimet publike dhe qeverisja lokale në fokus) dhe DEMI/USAID (Raport i Anketimit mbi Kënaqshmërinë e Qytetarëve me Shërbimet Komunale, 2012).



Instituti GAP është një Think-Tank i themeluar në tetor të 2007. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institute të ngjashme në shtetet perëndimore. GAP u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.